



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 367/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharem Shala kryesues, Ymer Hoxha dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Prishtinë, për shkak të vendosjes së banerit mbi rrugë publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 01.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Prishtinë, kështu që subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1500 (njëmijë e pesëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 29.10.2013, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga AKR, në të cilën pretendohet se me datën 29.10.2013, në Lagjen Tophane në Prishtinë, anëtarë të subjektit politik AAK, kanë vendosur pano të anëtarit të tyre, Visar Ballovcit mbi rrugë publike, ku me këtë veprim sipas parashtruesit të ankesës janë shkelje të , neni 3 pika 3.2 të Rregullores Zgjedhore.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik AAK, me datën 30.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 31.10.2013, brenda afatit të caktuar, PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë në të cilën theksohet se më të pranuar njoftimin për dukjen e banerit të kandidatit të AAK-së për Asamble Komonale në Prishtinë z. Visar Ballovcit mbi rrugën publike nuk është bërë nga ana e AAK-së, struktura menagjuese e fushatës, konkretisht shtabi zgjedhor për komunën e Prishtinës, ka bërë largimin e këtij baneri, dhe ka ofruar disa fotografi në të cilën dëshmohet veprimi i largimit të banerit të vendosur mbi rrugët publike të Prishtinës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografit të cilat gjenden në shkresat e lendes shihet çart se baneri i kandidatit të AAK-së për antarë të Asamblesë Komunale në Prishtinë është i vendosur mbi rrugë publike siç pretendohet në ankesën me te cilin veprim subjekti politik AAK ka rënë në kundërshtim me dispozitat ligjore te neni 33 pika b) të LZP-së.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe se i njëjti subjekt politik shkeljen e të njëjtës natyrë e ka përsëritur edhe më parë në këto zgjedhje. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori se AAK, pas marrjes së kërkesës për përgjigjes në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes, duke i larguar menjëherë fotografit nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura konstatoi se nga ana e subjektit AAK-së është shkelur neni 4 paragrafi 1 pika “b” të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, pasi që baneri në fjalë është vendosur mbi rrugë publike siç pretendohet në ankesë. Për lartësinë e gjobës së shqiptuar në diapozitiv të këtij vendimi ka ndikuar veprimet e menjëhershme te subjektit politik AAK ngase ka ndërmarr veprime të menjëhershme për evitimin e shkeljes së supozuar si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara siç kërkohen nga neni 32.6 të LZP-së, andaj në kuptim të neni, 120 paragrafi 1 pika c), si dhe neni 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 367/2013 më datën 01.11.2013.



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*